Biblioteka Kombëtare

Biblioteka Kombëtare është institucioni bibliotekar kryesor i vendit dhe njëherësh qendër studimore shkencore. E themeluar që në 10 dhjetor 1920 dhe e përuruar më 1922, ajo është biblioteka kryesore e vendit tonë. Me rastin e 80-vjetorit të krijimit të saj, Presidenti i Republikës i dha titullin e lartë "Nderi i kombit".

Si bërthamë e BKSh-së shërbeu fondi i i bibliotekës së "Komisisë Letrare Shqipe", organizëm i përbashkët shqiptaro-austriak, e krijuar në qytetin e Shkodrës në vitin 1917. Më 1920 ky fond u vendos në Ministrinë e Arsimit, Tiranë. Në momentin e përurimit si BKSh, 1922, ajo kishte rreth 6000 vëllime. Në vitet e Mbretërisë Shqiptare (1928-1937) spikat puna e drejtuesit, atdhetarit dhe lëvruesit të gjuhës shqipe, Sotir Kolea. Mbarimi i luftës II Botërore e gjeti BKSh me një koleksion prej 15.000 vëllimesh. U vendos në një nga ndërtesat më të mira të kohës., sot "aneks" i saj. Në fund të vitit 1947 fondi i saj numëronte rreth 100.000 vëllime. Ngjarje me rëndësi për BKSh, ishte dalja më 31.05.1948 e dekretit "Mbi dërgimin e detyrueshëm të shtypshkrimeve Bibliotekës Kombëtare", sipas të cilit asaj i dërgoheshin falas një numër ekzemplarësh të çdo shtypshkrimi të vendit. Ky dekret është ndryshuar e plotësuar disa herë; varianti i fundit është ai i vitit 1992, sipas të cilit botuesit detyrohen t'i dërgojnë BKSh nga 5 kopje të çdo botimi të tyre.

Nga institucion në varësi të Institutit të Shkencave, në vitin 1959 BKSh kaloi në vartësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës. Në vitin 1966 ajo u zhvendos në një pjesë të ndërtesës së re të Pallatit të Kulturës, ku gjendet edhe sot.

BKSh financohet nga shteti. Organizimi dhe funksionimi i saj bëhet nën autoritetin e MTKRS. BKSh ruan në fondin e saj materiale të ndryshme, duke filluar që nga dorëshkrimet e deri te mediat moderne. Si e tillë, kjo bibliotekë ka një sërë funksionesh.

- Është institucioni depozitues i kopjes së detyruar, ku përfshihen të gjitha llojet e informacionit, pavarësisht formës së regjistruar, duke krijuar e pasuruar arkivin kombëtar;
- BKSh grumbullon, pasuron, përpunon, ruan dhe vë në shërbim të përdoruesve botimet në gjuhën shqipe si dhe në gjuhë të huaj që përmbajnë informacion për Shqipërinë, kombin shqiptar dhe përbëjnë koleksionin albano-balkanologjik.

- BKSh grumbullon, pasuron, përpunon, ruan dhe vë në shërbim të përdoruesve koleksione të literaturës botërore të karakterit të përgjithshëm.

- BKSh është qendra e përgatitjes dhe e shërbimit të informacionit bibliografik kombëtar. Këtu botohen bibliografia kombëtare si dhe bibliografi korrente e retrospektive të llojeve të ndryshme. Këtu kryhet katologimi i librave për botim.

- BKSh realizon formimin dhe kualifikimin profesional të punonjësve të të gjithë rrjetit kombëtar të bibliotekave. Ajo shërben si një qendër e studimeve në fushën e bibliotekonomisë, bibliografisë dhe të shkencës së informacionit dhe punon për zhvillimin e këtyre fushave. Pranë BKSh funksionon edhe Qendra e Trajnimit Bibliotekar. Nga viti 1969 ajo organizon rregullisht një kurs dyvjeçar për aftësimin profesional, i cili është i vetmi në vend për dhënien e njohurive bibliotekare e të informacionit. Që prej vitit 1999 BKSh ka ngritur Qendrën e Trajnimit Bibliotekar, të mbështetur edhe nga Fondacioni SOROS. Programi i kësaj Qendre përfshin kurse trajnimi për punonjësit e tërë rrjetit të bibliotekave të vendit dhe ajo funksionon si shkollë për studimet pasuniversitare, për bibliotekarët që kanë mbaruar kursin dy-vjeçar

të bibliotekonomisë, ose janë rekretuar pas përfundimit të universitetit apo shkollave të tjera të larta. BKSh është qendra metodike për zbatimin e standardeve në tërë veprimtarinë bibliotekare.

- BKSh është qendër e restaurimit të materialeve bibliotekare, të cilat janë klasifikuar si trashëgimi kulturore dokumentare.

- Që nga viti 1997 pranë BKSh është krijuar dhe funksionon zyra e ISBN (International Standard Book Number-Numër Standard Ndërkombëtar i Librit) për botimet shqip.

- Në vitin 2004 pranë BKSh-së u ngrit American Corner.

BKSh numëron në fondet e veta rreth 1 milion vëllime (libra, periodikë, harta, atlase, mikrofilma e materiale të tjera). Fondi i arkivit të botimeve shqip, i antikuarit, i dorëshkrimeve, hartave, si dhe fondi i albano-balkanologjisë përbëjnë pasuri me vlera të mëdha për thesarin e kulturës kombëtare shqiptare e, si të tilla, të kulturës europiane.

Fondi i Arkivit: përfshin botime me vlera të veçanta për pasurinë e shkruar të shqiptarëve, duke filluar nga botimet e parë në gjuhën shqipe (shek.XVI) dhe duke vazhduar deri në ditët tona.

Fondi i Antikuarit: përbën një fond të posaçëm, shumë të rëndësishëm, jo aq nga numri i vëllimeve sa nga përmbajtja e tij. Në këtë fond ruhen botime të shekujve XV-XVIII, si dhe inkunabula.

Fondi i dorëshkrimeve: përmban dorëshkrime në gjuhët orientale, si dhe një numër të vogël në gjuhët perëndimore dhe në shqip. Këto u përkasin shekujve XV-XX. Kjo pjesë fondi llogaritet me vlerë të jashtëzakonshme për kulturën shqiptare, por edhe në kontekstin mesdhetar e atë europian. Aktualisht ai përfshin vepra më arabisht, në turqisht, në persisht dhe në dy ose tri gjuhë orientale njëherësh. Këto dorëshkrime kanë përmbajtje fetare, historike, gjuhësore, letrare dhe shkencore.
Në fondin e hartave të antikuarit ruhen harta me shtyp (riprodhim incizimesh në bakër), botime të vjetra me vlerë të hartografëve të shquar europianë, nga shekujt XV-XVIII.
Në fondin e albano-balkanologjisë ruhen të gjitha botimet shqipe, si dhe ato të huaja, që flasin për Shqipërinë, shqiptarët dhe popujt e ndryshëm të Ballkanit, që trajtojnë historinë, gjuhën, folklorin, kulturën e tyre. Sot qendra e studimeve albanologjike është përqëndruar në shtetin shqiptar dhe literatura bazë për këto studime ndodhet në këtë bibliotekë.

Koleksionet e BKSh-së pasurohen nëpërmjet ligjit të ekzemplarit të detyruar, shkëmbimit, dhuratave dhe blerjeve. Ajo njeh botimet me karakter albanologjik dhe i siguron ato. Gjithashtu përpiqet të sigurojë botime nga të gjitha degët e diturisë të karakterit referativ e informativ dhe që janë me interes për një numër sa më të madh përdoruesish.

Sa i përket raportit midis gjuhëve të literaturës së huaj, deri në vitet '70 zotëronte gjuha ruse, ndërsa më pas shpërndarja ka ardhur duke u përpjestar në mënyrë racionale, drejt zotërimit të gjuhëve perëndimore: anglisht, frëngjisht, gjermanisht etj.

Nëpërmjet Sektorit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare e Publike BKSh mban dhe kryen marrëdhënie dy dhe shumëpalëshe me bibliotekat dhe institucionet e tjera homologe, si dhe punon për anëtarsimet dhe pjesëmarrjet e veta në veprimtaritë e organizatave ndërkombëtare. Pas ndryshimeve demokratike në Shqipëri (pas viteve '90), BKSh është anëtarsuar në IFLA, CENL, CDNL, SEENL, GABRIEL, ELAG etj.
Riorganizimi i fondeve në vitet e para pas Luftës II-të Botërore, njohja e rregullave unike të përshkrimit dhe e tabelave të klasifikimit, diktoi ripunimin e të gjithë literaturës dhe krijimin e skedarëve alfabetikë e sistematikë. Klasifikimi dhjetor universal (KDU) u vu në zbatim në vitin 1964 dhe vazhdon të përdoret

duke ndjekur të gjitha plotësimet e ndryshimet që i bëhen sistemit nga Federata Ndërkombëtare e Dokumentacionit (FID).

KDU është sistemi që aktualisht përdoret në të gjithë rrjetin e bibliotekave në Shqipëri.
Standardet ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik (ISBD) dhe rregullat amerikane të katologimit (AACR2), BKSh i vuri në zbatim në vitin 1989. Katologimi lëndor i literaturës ka filluar në vitin 1995, pas hartimit nga specialistët e BKSh të Treguesit të Emërtimeve Lëndore në gjuhën shqipe.
BKSh ka sot një rrjet të gjerë skedarësh alfabetikë, sistematikë e lëndorë për të gjitha llojet e literaturës, si dhe kronologjik e gjeografik për një pjesë të tyre.

Sa i takon automatizimit, në vitin 1994 në BKSh u instalua programi CDS/ISIS, siguruar falas nga UNESCO dhe filloi katologimi në një sistem të automatizuar i hyrjeve të reja (libra). Ky vit shënon fillimet e krijimit të skedarit elektronik. Tanimë është krijuar baza e të dhënave për botimet shqiptare dhe të huaja, e disertacioneve shkencore, si edhe e artikujve të periodikut shqiptar e të huaj. Realizimi i plotë i projektit të automatizimit u mundësua në sajë të mbështetjes financiare të fondacionit SOROS, PNUD-it dhe të qeverisë shqiptare. BKSh ka instaluar një sistem të ri të integruar bibliotekar; ky është sistemi ADLIB.
Instalimi i Internetit, që prej vitit 1998, ka bërë të mundur komunikimin me botën duke realizuar një informacion të shpejtë e të larmishëm. Së afërmi, nëpërmjet Internetit BKSh do të realizojë vënien në shfrytëzim të vlerave të rralla, duke e bërë kështu informacionin të akcesueshëm për lexuesin shqiptar e të huaj.

Botimet: BKSh boton periodikisht, që nga viti 1959, Bibliografinë Kombëtare të Librit që botohet në Republikën e Shqipërisë dhe, që nga viti 1961, atë të Artikujve të Periodikut Shqip. Ky fillim relativisht vonë i veprimtarisë së organizuar bibliografike ka diktuar nevojën e përgatitjes së bibliografive retrospektive si për librin ashtu dhe për artikujt e periodikut. Punohet për Bibliografinë Retrospektive të Librit shqip të viteve 1555-1958.

Botim i rëndësishëm bibliografik është ai i Librit Shqip të Botuar Jashtë Shqipërisë, e cila ka filluar të realizohet nga viti 1981 dhe vijon periodikisht. Prej vitit 1969, BKSh merr pjesë në botimin bibliografik të UNESCO-s Index Trans-lationum, ku paraqiten dhe përkthimet që botohen në Shqipëri.
BKSh nga viti 1971 boton hyrjet e reja albano-balkanologjike në BKSh. Me specifikë të veçantë është seria “Albanica” (shqip-anglisht), që njeh studiuesit me fondin albanologjik. Vëllimi i parë përfshin libra të botuar në shekujt XV-XVIII, ndërsa i dyti botime të viteve 1800-1849. Në procesin e përgatitjes janë vëllimet në vazhdim.

Paraqet vlerë edhe seria bibliografike “Autorë të huaj për Shqipërinë dhe shqiptarët” I,II, ku paraqiten veprat e autorëve italiane (i) dhe francezë (II) që trajtojnë problemet e historisë, gjeografisë, etnografisë, kulturës shqiptare që prej shek.XIV e deri në ditët e sotme.

BKSh përgatit dhe boton tekste dhe manuale në ndihmë të bibliotekave të vendit.

Që nga viti 2000 BKSh boton organin e saj profesional "BIBLIOTHECAE".

BKSh numëron çdo vit rreth 7.000 anëtarë dhe 90.000 frekuentues. Qarkullon mbi 100.000 materiale bibliotekare në vit. Lexuesit mund të huazojnë materiale ose t'i shfrytëzojnë ato në sallat e leximit. Ka dy pika të huazimit të literaturës (në ndërtesën kryesore dhe në "aneksin" e vjetër) dhe pesë salla leximi. Të gjitha sallat kanë fond ndihmës me fjalorë, eniklopedi e materiale të tjera referative sipas profilit të tyre. Materialet me vlerë të veçantë (arkiv, antikuar, dorëshkrime etj.) shërbehen në sallën e leximit të posaçme për to. Dy sallat e leximit të shtypit (korent dhe retrospektiv) janë me fonde të hapura. Lexuesit gjejnë në këto salla edhe informacion në CD-ROM për fusha të ndryshme të shkencave. Në ndihmë të lexuesve

është zyra e informacionit, punonjësit e së cilës i orientojnë ata në gjithë aparatin informativ (skedarë, botime bibliografike, materiale referuese, INTERNET, katalog elektronik, etj).

Vend të veçantë në veprimtarinë e BKSh, sidomos pas viteve '90, zënë marrëdhëniet me publikun. Ajo organizon kolokiume shkencore kombëtare e ndërkombëtare, ekspozita, promovime botimesh me rëndësi kombëtare, konferenca me albano-balkanologë të ftuar nga jashtë etj.

Mirëmbajtja dhe restaurimi: Gjendjen e materialeve bibliotekare, seleksionimin e atyre të dëmtuara dhe restaurimin e tyre e kryen një sektor i ngarkuar për këtë detyrë.

Kontakt:
Adresa e BKSh: Sheshi "Skënderbe", Tiranë.
Tel./Fax: ++355 42 47482

Orari ditor:
Hënë-Premte 08.00-20.00
Shtunë-Dielë 08.00-14.00
Drejtor i BKSh-së: Prof.Dr. Aurel Plasari
Tel./Fax: ++355 42 23843

Zv/drejtor: Etleva Domi
Tel./Fax:++355 42 57670